



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, gusht 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit të Prishtinës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi, (udhëheqëse ekipi), Laureta Matoshi, Veton Misiri dhe Nora Rashiti (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Faruk Rrahmani.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1 Opinion i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	26
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	29

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Universitetit të Prishtinës (UP) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur dhe menaxhuar mirë, me përjashtim të disa çështjeve të shpalosjeve që i kemi theksuar më poshtë tek kategoritë përkatëse.

Universiteti i Prishtinës në përgjithësi, ka vendosur kontrole efektive për menaxhimin e të hyrave, përderisa për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë të shpenzimeve, ende nevojiten veprime shtesë. Mangësitë më të theksuara në fushën e shpenzimeve ishin në menaxhimin e pagave dhe shtesave përfshirë pagesat për komisione të ndryshme, nivelin e ulët të shpenzimeve kapitale dhe dobësive në proceset prokurimit. Për më tutje edhe regjistrimi i pronave në regjistrat e pasurive nuk ishte i plotë dhe sfidë mbetet menaxhimi i obligimeve të pa paguara.

Procesi i zbatimi të rekomandimeve nuk ishte në nivel të kënaqshëm. Nga dhjetë rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të vitit paraprak, katër rekomandime janë zbatuar, dy ishin adresuar pjesërisht dhe katër nuk janë adresuar ende. Si rezultat i përsëritjes së rekomandimeve, mangësi në sistemet domethënëse të Universitetit mbetin të pa trajtuara.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e UP-së, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorët të Përgjithshëm.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Universitetit të Prishtinës (UP) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga UP. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Prorektori për buxhet dhe financa i UP- së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Rektori është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të UP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

UP ka shpenzuar 81% të buxhetit final për vitin 2019. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive përderisa kontrollet e vendosura në fushën e shpenzimeve kërkojnë përmirësime të domosdoshme përmes veprimeve konkrete.

Fushat me probleme të theksuara të shpenzimet kanë të bëjnë me realizimin e ultë të buxhetit për projektet kapitale, mangësi në menaxhimin e pagave dhe shtesave, dhe menaxhim jo i mirë i shpenzimeve përmes prokurimit. Më tutje, obligimet nuk ishin menaxhuar mirë përderisa regjistri i pasurisë nuk përfshinte të gjitha pronat që janë në shfrytëzim të UP-së.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimi mit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	34,785,502	35,175,491	28,555,615	81%	29,514,154	27,000,209
Granti i Qeverisë –Buxheti	26,787,752	26,354,810	25,004,117	95%	25,001,073	22,782,088
Të bartura nga viti paraprak ³	-	848,232	494,821	58%	643,030	1,313
Të hyrat vetjake ⁴	3,997,750	3,997,750	1,187,354	30%	2,571,446	3,587,626
Te hyrat nga AKP ⁵	4,000,000	3,369,451	1,585,456	47%	879,486	-
Donacionet e brendshme	-	9,868	70	1%	-	5,290
Donacionet e jashtme	-	595,380	283,797	48%	419,119	623,892

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 389,989€. Kjo rritje është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak 848,232€ dhe donacioneve të brendshme e të jashtme 605,248€ dhe efekti i shkurtimeve me vendim të qeverisë prej 1,063,491€.

Në vitin 2019, UP ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 28,555,615€, me një zvogëlim prej 11% krahasuar me vitin 2018. Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁵ Të hyrat nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të ndara me ligj të buxhetit

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kat. ekonomike:	34,785,502	35,175,491	28,555,615	81%	29,514,154	27,000,209
Pagat dhe Mëditjet	21,263,857	22,452,764	20,535,259	91%	20,887,326	19,883,961
Mallrat dhe Shërbimet	3,402,645	4,342,304	3,442,710	79%	3,525,564	3,120,829
Shërbimet komunale	1,175,000	1,116,250	834,172	75%	987,256	903,331
Subvencionet dhe Transferet	1,444,000	1,714,031	653,319	38%	741,416	959,776
Investimet Kapitale	7,500,000	5,550,142	3,090,155	56%	3,372,592	2,132,312

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Ndryshime të theksuara të buxhetit final nga ai fillestar vërehen tek kategoria e pagave dhe meditjeve me një rritje prej 1,188,907€, si rezultat i rritjes prej 711,450€ me vendime të qeverisë, 477,210€ nga të hyrat e bartura dhe 247€ nga grantet. Ky nivel i realizimit të buxhetit final kishte ndodhur për shkak se nuk kishte rekrutime të reja dhe nuk ishin realizuar pagesat e parapara të honorarëve dhe mbi normave të profesorëve në mungesë të raporteve të realizimit të këtyre orëve, siç kërkohet me rregulloren e të ardhurave personale;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 939,659€. Kjo rritje ishte nga të hyrat e bartura 47,553€, grantet 603,283€ dhe ridestinimeve në vlerë prej 288,823€. Rritja kishte ndodhur me kërkesën e UP-së për pagesën obligimeve që përkasin kësaj kategorie;
- Rritja e buxhetit final në krahasim me buxhetin fillestar të subvencionet dhe transferet ishte 270,031€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave të bartura 323,441€ dhe nga grantet e donatoreve 1,600€, dhe zvogelimit nga kursimet buxhetore në vlerë 55,010€. Realizimi i buxhetit final prej 38%, ishte për shkak të mosrealizimit të bursave të parapara për doktoraturë të cilat nuk kanë mundur të ipen në mungesës të aprovimit të rregullores nga ana e Këshillit drejtues të UP-së; dhe
- Kategoria e investimeve kapitale kishte një zvogëlim prej 26%, apo 1,949,858€ që ishte rezultat kryesisht i shkurtimeve buxhetore në fund të vitit që kishin rezultuar për shkak të mos realizimit të disa projekteve të parapara.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga UP në 2019 ishin 2,995,888€, dhe arkëtohen për participimin e studentëve, shitjen e shërbimeve (super ekspertizat), shitja e mallrave etj. Me buxhetin final UP-së i ishin lejuar për shpenzime shuma prej 4,845,982€ nga të hyrat vetanake të vitit aktual dhe atyre të bartura nga viti paraprak, ndërsa i kishte shpenzuar 1,683,170€.

Në PFV, vërehet se të hyrat vetanake, janë shpалosur gabimisht te neni 23 të hyrat e dedikuara. Nga testimi i 29 mostrave substantive dhe 5 mostra në pajtueshmëri për të hyrat, nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	2,995,888	3,489,382	4,251,071

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 22,452,764€ dhe ishte realizuar 91%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,080 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,803. Gjatë vitit 2019 nuk kishte të punësuar të rinj, si rezultat i anulimit të konkurseve në mungesë të kandidatëve të suksesshëm.

Në shpалosjen PFV të raportit për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave, ishte paraqitur vetëm totali i punëtorëve, ndërsa mungonte shpалosja e numrit të punëtorëve sipas departamenteve.

Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 345,553€ si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 – Kompensime të ndryshme për çështjen e njëjtë brenda UP-së

Gjetja Neni 21 i rregullores nr. 2/486⁶ për të ardhurat personale përcakton lartësinë e kompensimit për mentorin dhe komisionet e doktoratës. Për kryetarin e komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të temës është përcaktuar kompensimi prej 200€.

Ne kemi vërejtur pagesa të ndryshme ndërmjet Fakulteteve të UP-së, në lidhje me kompensimin e Kryetarit të komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të temës së doktoratës. Vlerat me të cilat është paguar kryetari i komisionit kanë qenë nga 200⁷€, 350⁸€ dhe 400⁹€. Të gjitha vendimet mbi këto kompensime ishin nënshkruar nga Prorektorja për Buxhet dhe Financa. Vlen të theksohet se komisioni i vlerësimit dhe mbrojtjes të punimit në një proces të diplomimit zakonisht është i njëjtë, mirëpo mund të jetë edhe i ndryshëm.

Kjo ka ndodhur si pasojë e paqartësisë me rastin e përcaktimit të shumës së kompensimit në rregullore, pasi që, për anëtarët e komisionit është trajtuar ndaras kompensimi për procesin e vlerësimit dhe atë të mbrojtjes, ndërkaq kjo nuk ka ndodhur për kryetarin e komisionit.

Ndikimi Kompensimet e ndryshme për komisione të njëjta, në fakultete të ndryshme shkaktojnë trajtim jo të barabartë të stafit pjesëmarrës në këto komisione dhe kjo ndikon që paraja publike të shpenzohet në mënyrë jo të duhur.

Rekomandimi A1 Rektori duhet të sigurojë që kompensimet për kryetarin e komisionit të vlerësimit dhe mbrojtjes së temës së doktoratës të jenë konform rregullores dhe të njëjta për të gjitha Fakultetet, me qëllim të trajtimit të barabartë. Po ashtu duhet të vlerësohet mundësia e rishikimit të rregullores për të qartësuar dhe unifikuar këtë lloj kompensimi.

⁶ Rregullorja nr. 2/486 për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në UP – "Hasan Prishtina"

⁷ Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Filologjik, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Bujqësisë

⁸ Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore;

⁹ Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (në rastet kur komisioni I vlerësimit dhe ai i mbrojtjes është i ndryshëm);

Çështja B1 - Angazhimi në punë sekondare pa aprovim nga menaxhmenti i UP**Gjetja**

Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik nr. 2/486 në nenin 6 përcakton se: Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP mund të angazhohet me honorar në institucionet tjera, pasi që më parë të ketë marrë pëlqimin nga Dekani dhe miratimin nga rektori i UP-së, kurse neni 5 përcakton se: personeli me marrëdhënie të rregullt pune në UP (akademik ose jo - akademik) nuk mund të ketë marrëdhënie tjetër të rregullt të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet apo institucion tjetër. Ne identifikuam:

- 79 profesorë të cilët kanë marrëdhënie të rregullt pune me UP-në, njëkohësisht janë të angazhuar me punë sekondare në Universitetet tjera në kuadër të MASHT-it. Për këto angazhime, këta profesorë nuk kishin marrë miratimet paraprake nga Rektori i UP-së; dhe
- Në një rast, profesori në Fakultetin e Filologjisë së UP, ishte i angazhuar me kontratë edhe në dy institucione të tjera, për të njëjtën periudhë kohore. Njëra kontratë ishte si profesor i rregullt në njërin nga Universitetet private dhe një kontratë tjetër për honorarë në Universitetin Ukshin Hoti në Prizren.

Kjo kishte ndodhur për shkak se profesorët nuk kishin kërkuar miratim për punë sekondare nga menaxhmenti i UP-së në njërin anë, dhe monitorimi i dobët i menaxhmentit të UP-së ndaj personelit akademik në anën tjetër.

Ndikimi

Angazhimet e profesorëve për punë shtesë pa miratimin e menaxhmentit, përveç se është në kundërshtim me kërkesat e rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, ndikon në cilësisë e procesin arsimor për shkak të angazhimeve të shumta të personelit akademik.

Rekomandimi B1 Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuara dhe të marr masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk zbaton rregulloret.

Çështja B2 - Kompensimi jo në pajtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Vendimi i Këshillit Drejtues të UP-së nr. 2/901 i datës 13.10.2016, pika 10 përcakton: Rektori, prorektori, dekanët përveç mbajtjes së orëve mbi normë, nuk mund të kenë angazhim tjetër brenda dhe jashtë UP gjatë orarit të rregullt të punës. Po ashtu, Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë, neni 20 kompensimi i pagës, përcakton rastet kur nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës¹⁰.

UP në bashkëpunim me MASHT (në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me 21.11.2016) kishte vazhduar realizimin e programit “Avancimi dhe Kualifikimi i Mësimdhënësve” (AKM) dhe kishte organizuar Programin për Avancimin e Pedagogëve (PAP). Në këtë memorandum është caktuar Këshilli Drejtues i AKM¹¹ që përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të UP-së dhe tre (3) anëtarë të MASHT-it si dhe një grup i stafit administrativ¹² për të implementuar këtë projekt. Po ashtu, Rektori i UP-së është caktuar edhe Kryetar i Këshillit Drejtues (KD) të AKM. Qëllimi i këtij programi ishte të sigurohet avancimi i pedagogëve të cilët janë në marrëdhënie pune nëpër shkollat e Kosovës.

Me vendim nr. 690 të datës 18.04.2016, Kryetari i Këshillit¹³ Drejtues të AKM-së kishte caktuar norma mujore për kompensime për anëtarët e Këshillit Drejtues të AKM-së si dhe stafin tjetër administrativë (8 zyrtarë). Vlera e kompensimit ishte 590€, për Kryesuesin e KD, për anëtarët 490€ në muaj si dhe për stafin administrativ të cilat variojnë nga 80€-300€, në muaj. Ne kemi vërejtur se KD i AKM-së dhe stafi administrativ ishte kompensuar çdo muaj, përderisa nuk na janë ofruar dëshmi për të konfirmuar se të njëjtit kishin kryer punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës.

Shkaku i këtyre vendimeve ishte se menaxhmenti i UP-së ka konsideruar se angazhimet e tilla janë punë shtesë dhe për këtë duhet edhe të kompensohen.

¹⁰ Në këto raste: 1.1. kompensimi për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit

¹¹ Këshillin Drejtues të AKM e përbënë: rektori, prorektori për buxhet dhe financa, sekretar i përgjithshëm, dekan i fakultetit të edukimit etj.

¹² Grupi administrative përbëhet nga 8 zyrtarë të UP-së si: ZKF, zyrtar i pagave, sekretari i fakultetit të edukimit, zyrtar për çështje akademike dhe tjerët të përcaktuar nga KD

¹³ Kryetari i Këshillit Drejtues të AKM është Rektori i UP-së

Ndikimi Kompensimet e KD të AKM-së dhe të stafit administrativ, në mungesë të dëshmive për të konfirmuar se janë kryer punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, përveç që është në kundërshtim me vendimin e KD ndikon që buxheti të shpenzohet jo siç duhet.

Rekomandimi B2 Rektori duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në raste kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet mos të bëhen dhe të ndërpriten menjëherë.

Çështja A2 - Kompensime në kundërshtim me rregulloren

Gjetja Sipas rregullores nr. 917 për Kompensimin e punës së komisioneve të cilat themelohen në nivel të Universitetit, neni 3, paragrafet 3.3 dhe 3.4, kompensimi për punë shtesë dhe punë jashtë orarit nuk u takon rektorit, prorektorëve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, sekretarit të përgjithshëm të UP-së, dekanëve, prodekanëve, sekretarëve të njëjësive akademike dhe drejtorëve të Administratës Qendrore. Të njëjtëve u takon kompensimi vetëm kur angazhohen në komisione për punë të veçanta profesionale.

Ne vërejtëm se në pesë¹⁴ raste, janë kompensuar si anëtarë të komisionit për punë shtesë të cilat sipas zyrës për çështje akademike të UP-së, nuk konsiderohen si komisione profesionale. Vlera e këtyre kompensimeve ishte 1,312€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte marrë parasysh kufizimet e përcaktuara me rregulloren përkatëse.

Ndikimi Kompensimet për pjesëmarrje në komisione të personelit të cilat janë në kundërshtim me rregulloren shkaktojnë pagesa të parregullta.

Rekomandimi A2 Rektori duhet të sigurojë që nuk do të ketë kompensime për pjesëmarrje në komisione personeli që sipas rregullores nuk u takon kompensimi. Aty ku janë identifikuar gabimet në këto lloj kompensimesh, të ndërmerren masat për kthimin e mjeteve.

¹⁴ Prorektorja për buxhet e financa, prorektorja për recesentë, sekretari dhe 2 anëtar të këshillit drejtues.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2019 ishte 5,458,554€, prej tyre ishin shpenzuar 4,276,882€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me material zyrtar, derivate të naftës, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime zyrtare, shërbime të mirëmbajtje etj. Kemi testuar 40 mostra për teste substanciale në vlerë 1,201,996€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në pesë pagesa për mallra dhe shërbime kemi identifikuar se zotimi apo urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës. Kjo ka ndodhur për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme, për ta parandaluar këtë praktikë që po përsëritet vit pas viti.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, ndikon që UP mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3 Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,714,031€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 653,319€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndarjen e bursave universitare për studime, dhe pjesëmarrje të personelit akademik në projekte hulumtuese shkencore, konferencat shkencore ndërkombëtare etj. Kemi testuar 7 mostra për teste substanciale në vlerë 4,785€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,550,142€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 3,090,155€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me pajisje laboratorike, renovimi i objekteve universitare, etj. Kemi testuar 30 mostra për teste substanciale në vlerë 2,218,384€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Realizim i ulët i projekteve kapitale

Gjetja Sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2019, UP në tabelat e projekteve kapitale kishte fonde të parapara për të realizuar 17 projekte në vlerë 7,500,000€. Prej këtyre, në 8 (tetë) projekte nuk kishte pasur asnjë shpenzim gjatë vitit, ndërsa në 2 (dy) të tjerë shpenzimi ishte nën 18%. Si rezultat i performancës jo të mirë, me vendime të qeverisë buxheti ishte zvogëluar për 1,949,858€. Përkundër zvogëlimit të buxhetit të projekteve, UP nuk kishte arritur të realizonte më shumë se 56% të tij.

UP në vazhdimësi ka probleme në realizimin e buxhetit të investimeve kapitale sidomos te objektet e reja. Kjo po ndodhë për shkak se projektet po buxhetohen pa u kryer procedurat administrative në lidhje me vendin e ndërtimit dhe marrjen e lejes së ndërtimit. Po ashtu, problem tjetër ishte edhe vonesat në furnizimet me pajisje laboratorike të cilat janë specifike dhe marrin kohë në liferim.

Ndikimi Niveli i ulët i realizimit të projekteve rezulton në shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion dhe e gjithë kjo ndikon në mos arritjen e objektivave të parapara dhe rrjedhimisht edhe në cilësinë dhe ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve.

Rekomandimi A3 Rektori duhet të sigurojë që buxhetimit të projekteve kapitale (ndërtimeve të reja) i paraprijnë zgjidhja e barrierave administrative në lidhje me lokacionin dhe lejet e ndërtimit. Po ashtu, realizimi i projekteve kapitale duhet të monitorohet në mënyrë sistematike për të adresuar pengesat për realizim/furnizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.

Çështja A4 - Ndryshimi i sasive të paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimet e kërkuara

Gjetja Sipas nenit 61.23 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik “Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet OE para marrjes së aprovimit nga ZKA”. Po ashtu pika 61.21 (Ndryshimi i kontratës) thekson që në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Ndryshimet e sasive lejohen te kontratat kornizë.

Te projekti “*Renovimi i objekteve në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”*”, përkatësisht Renovim në Fakultetin e Edukimit (Lloti X), te pagesa e bërë prej 12,862€ është rritur vendosja e sasisë së parketit nga 42 m² (sa ka qenë e paraparë në kontratë) në 217.3 m² më tepër se pozicioni i kontraktuar, edhe pse çmimi total i kontratës nuk kishte ndryshuar. Aprovimet për këto ndryshime nuk ishin marr nga ZKA dhe projektuesi, por vetëm nga organi mbikqyrës dhe menaxheri i projektit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se me rastin e planifikimit të projektit nuk ishin marrë parasysh nevojat reale për renovime në këtë Fakultet.

Ndikimi Mungesa e aprovimeve paraprake për ndryshime në sasi të pozicioneve gjatë një pune ndërtimore tregon dobësitë e kontratës dhe kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë duke sjellur edhe komplikime financiare.

Rekomandimi A4 Rektori duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të projekteve për renovim janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet renovuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të evitohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga projektuesi dhe ZKA.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 20,669,974€, pasurive jokapitale është 1,239,998€, si dhe e stoqeve 838,023€. Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 6,551,125€, si dhe procesin e inventarizimit të pasurisë si test të pajtueshmërisë. Në lidhje me prezantimin e pasurive në PFV, kemi identifikuar se tek neni 19.3.2 i PFV, Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro), pasuritë nuk janë shpalosur sipas nënkategorive apo kodeve, mirëpo është shpalosur vetëm totali i tyre.

Çështja B4 – Nënvlërësim i regjistrit të pasurive

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat¹⁵ që janë në shfrytëzim të UP-së, për shkak të problemeve të pa zgjidhura pronësore në mes UP-së dhe Komunës së Prishtinës.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pronave në regjistrin e pasurisë reflekton në nënvlërësim të informatave mbi gjendjen e pasurisë. Kjo ndikon në prezantim jo të drejtë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi B4 Rektori duhet të ndërmerri veprime konkrete lidhur me rregullimin e pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës me qëllim që pasuritë kapitale të prezantohen në mënyrë të plotë.

2.3 Të arkëtueshmet

UP në PFV e vitit 2019 ka shpallur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 76,400€ dhe krahasuar me vitin e kaluar (81,650€) shuma e këtyre llogarive është rritur për 5,250€. Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë me shumatat e pa inkasuara nga super ekspertizat që i bën Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 721,558€¹⁶. Krahasuar me vitin 2018, ka një rënie të këtyre detyrimeve për 254,782€ (2018 - 976,340€). Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Obligimet e pa paguara kryesisht kanë të bëjnë me pagesat për honorarët e profesorëve, si dhe vonesat e faturave.

¹⁵ Objekti dhe parcela e rektoratit, kompleksi universitar, kompleksi i qendrës së studentëve, kompleksi në QKUK, kompleksi i banesave universitare.

¹⁶ Kjo shumë është prezantuar nga UP

Çështja A5 - Menaxhimi i obligimeve të papaguara dhe trajtimi i tyre nga gjykatat/përmbauesit**Gjetja**

Neni 39 i LMFPP përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Më tutje, sipas rregullës financiare nr.01/2013 për shpenzimin e parave publike, neni 24 - pranimi dhe pagesa e faturës - të gjitha faturat duhet të pranohen duke zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit. Ne kemi identifikuar se:

- Në dy raste kishte vonesa për pagesat e faturave në vlerë prej 34,343€ deri në pesë muaj. Për më tepër këto fatura ishin pranuar dhe protokoluara në vitin 2019, dhe të njëjtat ishin pranuar edhe njëherë në vitin 2020 me numër të ri të protokollit;
- Bazuar në regjistrin e obligimeve të papaguara për vitin 2019, identifikuam katër raste të vonesave në pagesën e faturave rreth dy vite. UP nuk ka qenë në gjendje të na ofroj këto fatura për të konfirmuar saktësinë e tyre;
- Vlera e realizuar nga Thesari nga kodet e vendimeve gjyqësore ishte 465,059€. Prej tyre 331,775€ ishin obligime të viteve të mëhershme të UP-së ndaj ATK për kontributet pensionale dhe tatimet e mbajtura në burim për shtesat e profesorëve, që nuk ishin paguar. Këto ishin ekzekutuar nga kodi i vendime gjyqësore, bazuar në urdhër vjeljen e ATK-së dërguar në Thesar.

Ndërsa pjesa prej 133,284€ ishin për pagesën e pagave jubilarë për mësimdhënësit dhe nga faturat të cilat nuk ishin paguar me kohë. Prej tyre borxhi kryesor ishte 124,272€ dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbauesit) ishin 9,012€. Arsyet e mos pagesës me kohë të obligimeve ishin kryesisht mos planifikim i buxhetit për shpenzime të pagave jubilarë dhe në disa raste, pranimi me vonesë i faturave në financa.

Ndikimi

Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve dhe pranimi i dyfishtë i tyre mund të rezultojnë në rritjen e pagesave përmes vendimeve gjyqësore, e këto pastaj ndikojnë në rritjen e shpenzimeve shtesë të UP-së.

Rekomandimi A5

Rektori duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.

2.4.2 Detyrimet kontingjente

Vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PF për vitin 2019 ishte 1,332,181€, me një zvogëlim prej 463,258€ (2018/1,795,439€). Tek shpalosjet e detyrimeve kontingjente në PFV, kemi vërejtur mangësi, pasi që nuk ishin raportuar shifrat krahasuese të detyrimeve kontingjente për dy vitet paraprake.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrimeve kontraktuale të UP-së në fund të vitit 2019 ishte 527,600¹⁷€. Këto janë kontrata në vazhdim të UP, që kanë qenë të buxhetuara dhe të lidhura në afat më të gjatë se një vit, të cilat pritet të implementohen brenda tri viteve të ardhshme.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

UP ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me një auditor i cili njëkohësisht është edhe Drejtor i NjAB-së.

Për vitin 2019, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik, ku kishte planifikuar që të kryej pesë (5) auditime të rregullta. NjAB gjatë vitit 2019 kishte arritur të realizojë në tërësi auditimet e parapara në planin vjetor dhe poashtu kishte kryer edhe një auditim shtesë me kërkesë të menaxhmentit.

Në kuadër të auditimeve të kryera ishin përfshirë shumica e njësive organizative të UP, me prioritet sistemet me rrezik më të lartë, siç janë: menaxhimi i shpenzimeve për paga dhe shtesa, menaxhimi i pasurive dhe procedurat e prokurimit. Periudha e mbuluar kryesisht në raportet e NjAB përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Numri i rekomandimeve të dhëna nga NjAB për vitin 2019 ishte 23 rekomandime. Nga këto rekomandime, një ishte zbatuar, 15 janë në proces të zbatimit dhe 7 nuk janë zbatuar.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër takime gjatë vitit 2019, ku në takimet e mbajtura kishte diskutuar për raportet e auditimit të NjAB.

¹⁷ Vlera është paraqitur sipas shënimeve të marra nga UP

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të UP -së ka rezultuar me 10 rekomandime. UP kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

UP ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve shtator 2019 sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, katër rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces dhe katër nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Rektori duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me rregullimin e pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës me qëllim që pasuritë kapitale të prezantohen në mënyrë të plotë;</p> <p>Veç kësaj, Rektori duhet të siguroj se projektet që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve të mos planifikohen në kategorinë e investimeve kapitale por në kategorinë adekuate; dhe</p> <p>Detyrimet Kontingjente të shpalesen saktë si dhe të ofrohen sqarime të plota edhe për dy vitet paraprake.</p>	<p>Rekomandimi për rregullimin e pronësisë nuk është zbatuar Ref. Çështja B4</p> <p>Pjesa e rekomandimit që ka të bëjë me keq klasifikim është implementuar.</p> <p>Pjesa e rekomandimit që ka të bëjë me shpalesjen e viteve paraprake për detyrimet kontingjente nuk ishte zbatuar.</p>	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Procesi i buxhetit	Rektori duhet të përmirësoj kontrollet në fushën e planifikimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit për t'u siguruar se devijimet buxhetore në mes të planifikimit dhe realizimit të jenë sa më të vogla.	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2019.	Rekomandim i pa zbatuar.
3	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuar dhe të marr masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk zbaton rregulloret.	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2019.	Rekomandim i pa zbatuar.
4	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në rast kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet mos të	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2019.	Rekomandim i pa zbatuar.

		bëhen dhe të ndërpriten menjëherë.		
5	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të siguroj që personeli akademik i rregullt në të gjitha njësitë akademike evidentohet në listën e vajtje ardhjes për të siguruar se është duke u respektuar orari i punës.	Nga mostrat e vitit 2019 nuk kemi hasur ne pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
6	Mallra dhe shërbime	Këshilli Drejtues të siguroj që para marrjes së çdo vendimi, është sqaruar qëndrueshmëria e bazës ligjore për të gjitha pagesat, si dhe kompensimet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.	Nga mostrat e vitit 2019 nuk kemi hasur në pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
7	Mallra dhe shërbime	Rektori i UP-së duhet të siguroj ndërprerjen e këtyre kompensimeve si dhe pagesa të tilla nuk do të bëhen në të ardhmen.	Nga mostrat e vitit 2019 nuk kemi hasur në pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar.
8	Mallra dhe shërbime	Rektori duhet të forcoj kontrollat e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në disa nga mostrat e vitit 2019.	Rekomandim i pa zbatuar.
9	Investimet kapitale	Rektori duhet të forcoj masat e përgjegjësisë ndaj personelit mbikëqyrës të projekteve për tu siguruar që ekzekutimi i punimeve kryhet në pajtim me kushtet e kontratës. Pagesat e bëra më shumë se sa kryerja e punëve të kthehen në buxhetin e UP-së.	Nga mostrat e vitit 2019 nuk kemi hasur në raste të tilla, mirëpo për rastin përkatës ne rekomandim, mjetet nuk ishin kthyer.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
10	Raportimi jo i plotë i obligimev	Rektori duhet të siguroj që zyrtarët përgjegjës të regjistrojnë dhe azhurnojnë të gjitha evidencat për obligimet e	Nga mostrat e vitit 2019 nuk kemi hasur ne pagesa të tilla.	Rekomandim i zbatuar.

	e të pa paguara	papaguara në mënyrë që ato të paguhen me kohë dhe të raportohen drejtë në PFV.		
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Paga dhe mëditje	Rektori duhet të sigurojë që kompensimet për kryetarin e komisionit të vlerësimin dhe mbrojtjes së temës së doktoratës të jenë konform rregullores dhe të njëjta për të gjitha Fakultetet, me qëllim të trajtimit të barabartë. Po ashtu duhet të vlerësohet mundësia e rishikimit të rregullores për të qartësuar dhe unifikuar këtë lloj kompensimi.		
2	Paga dhe mëditje	Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuar dhe të marr masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk zbaton rregulloret.		
3	Paga dhe mëditje	Rektori duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në raste kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet mos të bëhen dhe të ndërpriten menjëherë.		
4	Paga dhe mëditje	Rektori duhet të sigurojë që nuk do të ketë kompensime për pjesëmarrje në komisione personeli që sipas rregullores nuk u takon kompensimi. Aty ku janë identifikuar gabimet në këto lloj kompensimesh, të ndërmerren masat për kthimin e mjeteve.		
5	Mallra dhe shërbimeve e	Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.		
6	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë që buxhetimit të projekteve kapitale (ndërtimeve të reja) i paraprijnë zgjidhja e barrierave administrative në lidhje me lokacionin dhe lejet e ndërtimit. Po ashtu, realizimi i projekteve kapitale duhet të monitorohet në mënyrë sistematike për të adresuar pengesat për realizim/furnizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.		
7	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të projekteve për renovim janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet renovuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të evitohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga projektuesi dhe ZKA.		

8	Pasuritë	Rektori duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me rregullimin e pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës me qëllim që pasuritë kapitale të prezantohen në mënyrë të plotë.
9	Obligimet e pa paguara	Rektori duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuarra paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Universiteti i Prishtinës
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS
"Hasan Prishtina"

"Nëna Terezë", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381-38-244183

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-244187

Mail: rektorati@uni-pr.edu

Prorektor

Prof. dr. Myrvete Badivuku

Ref.nr 1/614

Prishtinë, 12 . 8 .2020

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Draft Raportin e auditimit për vitin 2019 të datë 10.08.2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar Draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kemi ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Data: 12 Gusht, 2020, Prishtinë,

Me Respekt,

Prof. dr. Myrvete Badivuku Pantina

Prorektore për Buxhet dhe Financa në UJ



Myrvete Badivuku